



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 808/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.12.2019, shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-39828-10-16-2019, me objekt: *“Instalim i sistemit të alarmit për linjën e furnizimit me gaz në objektet parashkolllore të Bashkisë së Tiranës”*, me fond limit 1 365 900 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 28.10.2019 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.
- Ankimues:** “Eurogjici Security” sh.p.k  
Rr. “Adem Jashari”, L.8, H.10, Ap 3, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.  
Rruga “5 Maji”, Godina 17, Tregu i Medresesë, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.10.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-39828-10-16-2019, me objekt: “*Instalim i sistemit të alarmit për linjën e furnizimit me gaz në objektet parashkollore të Bashkisë së Tiranës*”, me fond limit 1 365 900 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 28.10.2019 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.

II.2. Në datën 05.11.2019 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

- |                                |                              |
|--------------------------------|------------------------------|
| 1. “Eurogjici Security” sh.p.k | 1.349.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “PC Store” sh.p.k           | 1.349.000 lekë, skualifikuar |
| 3. “ISM Gas” sh.p.k            | 1.363.129 lekë, skualifikuar |

Operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k rezulton i skualifikuar nga KVO me argumentat si më poshtë vijon:

“*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të Operatori ekonomik “EUROGJICI SECURITY” sh.p.k me NIPT K31929010K me ofertën ekonomike me vlere 1.349.000 (një milion e treqind e dyzet e nëntë mijë) lekë pa TVSH, u konstatua se:*

- *I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim.*

- Nuk plotëson kriteret e veçanta të përcaktuara në DT.
- Nuk plotëson specifikimet teknike të përcaktuara në DT.
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk ka gabime aritmetike.

Nuk plotëson piken 2.2 gërma d) të kapacitetit teknik si më poshtë:

a) Ofertuesi duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo më pak se 40 % të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore të cilat detyrimisht duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor. Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik të paraqesë faturat tatimore, (ku të shprehen qartë datat, shumat, sasitë, emërtimet, vlerat). Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik rezulton se kontratat e paraqitura nuk kanë objektin e kërkuar në këtë procedurë prokurimi. “Instalim i sistemit të alarmit për linjën e furnizimit me gaz në objektet parashkollore të Bashkisë së Tiranës” është krejtësisht i ndryshëm nga instalimi i kamerave të sigurisë në objekte. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se oferta nuk përmban të gjithë dokumentacionin e kërkuar në dokumentet e tenderit, referuar listës së kërkesave të tenderit, në mbështetje të pikës 3 të nenit 66 të VKM-se nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje me nenin 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, u konstatua se oferta e operatorit ekonomik “EUROGJICI SECURITY” sh.p.k nuk është në përputhje me kërkesat e tenderit, duke e cilësuar si ofertë të pa vlefshme.”

II.3. Në datën 08.11.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“Ne kriteret e Veçanta të kualifikimit, pika 2.2., "d" Per kapacitetin ekonomik dhe financiar eshte kerkuar: "Ofertuesi duhet te kete kryer sherbime te ngjashme ne nje vlere jo me pak se 40 % te fondit limit, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit. Kontrata te realizuara me autoritete kontraktore te cilat detyrimisht duhet te jene te shoqeruara me vertetimin e realizimit me sukses te saj, leshuar nga autoriteti kontraktor. Per sherbime te realizuara me subjekte private operatori ekonomik te paraqese faturat tatimore, (ku te shprehen qarte datat, shumat, sasite, emertimet, vlerat). "

Ne permbushje te kriterit te mesiperme, shoqeria jone ka ngarkuar ne sistemin (SPE) Kontratat si me poshte:

Kontrate me DRFPPNr.1,TiraneN, r.457 dt.29.12.2016-, Nr.1026. dt. 29.12.2017-2018, me objekt "Sherbimi i Ruajtjes dhe Sigurise Fizike me roje private, me sistem alarmi dhe sistem Kamerash per Drejtorine Rajonale te Formimit Profesional Publik", te instaluar nga Shoqeria jone, Referenca dhe Faturat perkatese.

Kontrate me I. Gjonaj Nr. 800. dt.13.10.2017 me objekt "Instalim dhe Konfigurim te sistemit te alarmit me kamera me pajisjet e sipermarresit, vezhgim dhe montorim i pandërprere 24 orësh në ambiente të jashtme të objektit, Kontroll fizik, Grup të Gatshëm 24 orë në 24 pa ndërprerje, për të gjitha rastet kur provokohet sistemi i vëzhgimit" dhe Faturat perkatese.

Kontrate me OSHEE Shkoder Nr.1518, dt.20.10.2017, me objekt "Sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike te objekteve ne varesi te Drejtoria Rajonale Shkoder, per lotin e pare Shkoder", (ku ne

specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve), me vlere (17.022.981 Lek pa TVsh), dhe Reference per realizim Kontrate.

Kontrate me OSHEE-Burrel, Nr. 1066, date 10.06.2016, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" ku ne specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve, sisteme keto te instaluar nga shoqeria jone), afat nga data 10.06.2016-09.06.2017, Vlere (27.534.444 Lek pa Tvsh) dhe Faturat perkatese.

Kontrat me OSHEE-Burrel, Nr. 440/6, date 07.06.2017, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" ku ne specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve), me afat nga data 10.06.2017- 09.06.2018, vlere (27.174.180 lek Pa Tvsh) dhe Faturat perkatese.

Kontrate OSHEE-Burrel Nr. 404/7, date 07.06.2018, "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" ku ne specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve), me afat nga data 10.06.2018-09.06.2019, vlere (18.9.99.907 lek Pa Tvsh) 1.3.A dhe Faturat perkatese.

Bazuar ne kerkesat e kriterëve te kualifikimit, del qarte se ajo qe kerkohet eshte qe: "Ofertuesi duhet te kete kryer sherbime te ngiashme ne nje vlere jo me pak se 40 % te fondit limit, te realizuara gjate 3 (tre) viteve tefundit nga data e zhvillimit te tenderit. "

Objekti i kontrates eshte "Instalim i sistemit te alarmit per linjen e furnizimit me gaz ne objektet parashkollore te Bashkise se Tiranes" dhe nese i referohemi Kontratave te paraqitura nga ana jone, te gjitha keto Kontrata kane ne permbajtje te tyre objektin e kerkuar per kryerjen e Sherbimit. Qellimi kryesor eshte instalim i sistemit te alarmit ne objektet parashkollore te Bashkise se Tiranes nga operatori ekonomik, pavaresisht specifikave te caktuara lidhur me rrjetin e gazit, per te cilat jane paraqitur certifikatat perkatese per punonjesit e specializuar per keto pajisje, qe garantojne sherbimin ne baze te standarteve te kerkuara nga autoriteti kontraktor.

1- Certifikate trajnimi " Teknik per pajisjet me gaz" E. Gjici

2- Certifikate trajnimi " Teknik per pajisjet me gaz" F. Gjiana.

Sipas VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 3 paragrafi 1, percaktohet se: "Per te provuar pervojen e meparshme, autoriteti kontraktor kerkon deshmi per (sherbimet e meparshme, te ngiashme), te kryera gjate tri viteve te fundit. Ne cdo rast, vlere e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit.

Per te vertetuar kapacitetet e shoqerise, kemi paraqitur pune te ngjashme sipas kerkesave te ligjit, te cilat jane me se te mjaftueshme, madje tejkalojne kerkesat e autoritetit kontraktor dhe skualifikimi i shoqerise sone me nje arsyetim te tille, cenon parimet e konkurences se lire ne tendera

Arsyeja skualifikimit eshte ne interpretim te gabuar te ligjit pasi ndodhemi ne kushtet kur vete autoriteti kontraktor ne Dokumentat Standarte te Tenderit, ka kerkuar sherbime te ngiashme dhe jo identike. Per sa kemi realizuar sherbime te ngjashme per instalim te sinjaleve te alarmit, ruajtje me sinjal alarmi, vertetuar kjo edhe me Kontratat perkatese, certifikatat per punonjes te specializuar per pajisjet me gaz dhe ka plotesuar dokumentacionin e nevojshem sipas te gjitha kerkesave, eshte arritur qellimi kryesor per te krijuar nje panorame te qarte te kapaciteteve te

*Shoqerise per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar dhe per rrjedhoje, qendrimi i Autoritetit Kontraktor per te skualifikuar Shoqerine tone, eshte tendencioz dhe ne kundershtrim te plote me ligjin dhe vete kriterin e kualifikimit.*

*Per sa kemi sqaruar me siper eshte e qarte qe pretendimi i autoriteti kontraktor nuk qendron.” Si perfundim, kerkojme:*

- 1. Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;*
- 2. Kualifikimin e shoqerise sone, sipas percaktimeve te mesiperme;*
- 3. Dergimin prane selise se shoqerise sone, te nje kopje te vendimit te arsyetuar brenda afatit te parashikuar ne LPP.*

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 3931/4 prot., datë 13.11.2019 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit duke e refuzuar ankesën si më poshtë:

*“Pas shqyrtimit te ankeses dhe referimit me dokumentat standarde te tenderit po ju paraqesim vendimin e autoritetit kontraktor ne lidhje me ankesen tuaj per proceduren e prokurimit publik me objekt "Instalim i sistemit te alarmit per linjen e furnizimit me gaz ne objektet parashkollore te Bashkise se Tiranes", ne baze te ankeses suaj, si me poshte vijon:*

*1) Per sa i perket ankeses per piken 2.2 pika d) te kriterëve te vecanta...*

*“Ofertuesi duhet te kete kryer sherbime te ngjashme ne nje vlere jo me pak se 40 % te fondit limit, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit. Kontrata te realizuara me autoritete kontraktore te cilat detyrimisht duhet te jene te shoqeruara me vertetimin e realizimit me sukses te saj, leshuar nga autoriteti kontraktor. Per sherbime te realizuara me subjekte private operatori ekonomik te paraqese faturat tatimore, (ku te shprehen qarte datat, shumat, sasite, emertimet, vlerat).”*

*Me arsyetimin e meposhtem se...*

*Ne permbushje te kriterit to mesiperme, shoqeria jone ka ngarkuar ne sistemin (SPE) Kontratat si me poshte: Kontrate me DRFPP Nr.1, Tirane Nr.457 dt.29.12.2016, Nr.1026. dt. 29.12.2017-2018, me objekt "Sherbimi i Ruajtjes dhe Sigurise Fizike me roje private, me sistem alarmi dhe sistem Kamerash per Drejtorine Rajonale te Formimit Profesional Publik", te instaluara nga Shoqeria jone, Referenca dhe Faturat perkatese. Kontrate me I. Gjonaj Nr. 800. dt.13.10.2017 me objekt "Instalim dhe Konfigurim te sistemit te alarmit me kamera me pajisjet e sipermarresit, vezhgim dhe montorim i panderprere 24 oresh ne ambiente te jashtme te objektit, Kontroll fizik, Grup te Gatshem 24 ore ne 24 pa nderprerje, per te gjitha rastet kur provokohet sistemi i vezhgimit" dhe Faturat perkatese. Kontrate me OSHEE Shkoder Nr.1518, dt.20.10.2017, me objekt "Sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike te objekteve ne varesi te Drejtoria Rajonale Shkoder, per lotin e pare Shkoder", (ku ne specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve), me vlere (17.022.981 Lek pa TVsh), dhe Reference per realizim Kontrate. Kontrate me OSHEE-Burrel, Nr. 1066, date 10.06.2016, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" ku ne specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve, sisteme keto te instaluara nga shoqeria jone), afat nga data 10.06.2016-09.06.2017, Vlere (27.534.444 Lek pa Tvsh) dhe Faturat perkatese. Kontrat me OSHEE-Burrel, Nr. 440/6, date 07.06.2017, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" ku ne specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te*

objekteve), me afat nga data 10.06.2017- 09.06.2018, vlere (27.174.180 lek Pa Tvsh) dhe Faturat perkatese. Kontrate OSHEE-Burrel Nr. 404/7, date 07.06.2018, "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" ku ne specifikimet teknike percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve), me afat nga data 10.06.2018-09.06.2019, vlere (18.9.99.907 lek Pa Tvsh) 1.3.A dhe Faturat perkatese.

Bazuar ne kerkesat e kritereve te kualifikimit, del qarte se ajo qe kerkohet eshte qe: "Ofertuesi duhet te kete kryer sherbime te ngiashme ne nje vlere jo me pak se 40 % te fondit limit, te realizuara gjate 3 (tre) viteve tefundit nga data e zhvillimit te tenderit. "

Objekti i kontrates eshte "Instalim i sistemit te alarmit per linjen e furnizimit me gaz ne objektet parashkollore te Bashkise se Tiranes" dhe nese i referohemi Kontratave te paraqitura nga ana jone, te gjitha keto Kontrata kane ne permbajtje te tyre objektin e kerkuar per kryerjen e Sherbimit. Qellimi kryesor eshte instalim i sistemit te alarmit ne objektet parashkollore te Bashkise se Tiranes nga operatori ekonomik, pavaresisht specifikave te caktuara lidhur me rrjetin e gazit, per te cilat jane paraqitur certifikatat perkatese per punonjesit e specializuar per keto pajisje, qe garantojne sherbimin ne baze te standarteve te kerkuara nga autoriteti kontraktor.

1- Certifikate trajnimi " Teknik per pajisjet me gaz" E. Gjici

2- Certifikate trajnimi " Teknik per pajisjet me gaz" F. Gjiana.

Sipas VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, neni 28, pika 3 paragrafi 1, percaktohet se: "Per te provuar pervojen e meparshme, autoriteti kontraktor kerkon deshmi per (sherbimet e meparshme, te ngiashme), te kryera gjate tri viteve te fundit. Ne cdo rast, vlera e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 40% te vleres se perllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit. Per te vertetuar kapacitetet e shoqerise, kemi paraqitur pune te ngjashme sipas kerkesave te ligjit, te cilat jane me se te mjaftueshme, madje tejkalojne kerkesat e autoritetit kontraktor dhe skualifikimi i shoqerise sone me nje arsytim te tille, cenon parimet e konkureses se lire ne tendera. Arsyeya skualifikimit eshte ne interpretim te gabuar te ligjit pasi ndodhemi ne kushtet kur vete autoriteti kontraktor ne Dokumentat Standarte te Tenderit, ka kerkuar sherbime te ngiashme dhe jo identike. Per sa kemi realizuar sherbime te ngjashme per instalim te sinjaleve te alarmit, ruajtje me sinjal alarmi, vertetuar kjo edhe me Kontratat perkatese, certifikatat per punonjes te specializuar per pajisjet me gaz dhe ka plotesuar dokumentacionin e nevojshem sipas te gjitha kerkesave, eshte arritur qellimi kryesor per te krijuar nje panorame te qarte te kapaciteteve te Shoqerise per realizimin me sukses te sherbimit te kerkuar dhe per rrjedhoje, qendrimi i Autoritetit Kontraktor per te skualifikuar Shoqerine tone, eshte tendencioz dhe ne kundershtrim te plote me ligjin dhe vete kriterin e kualifikimit.

Per sa kemi sqaruar me siper eshte e qarte qe pretendimi i autoriteti kontraktor nuk qendron." Si perfundim, kerkojme:

1. Pezullimin e procedures deri ne shqyrtimin e plote te ankeses;

2. Kualifikimin e shoqerise sone, sipas percaktimeve te mesiperme;

3. Dergimin prane selise se shoqerise sone, te nje kopje te vendimit te arsytuar brenda afatit te parashikuar ne LPP.

Ne lidhje me ankesen e mesiperme Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave arsyeton si me poshte vijon:

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave pas shqyrtimit te ankeses, dokumentacionit bashkengjitur, informacionit dhe dokumentacionit te autoritetit kontraktor lidhur me arsyen e skualifikimit te operatorit ekonomik ankimues "Eurogjici Security" sh.p.k. Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, veren se: Ne shtojcen 8 "Kriteret e vecanta te kualifikimit", "Kapaciteti teknik" e dokumentave te tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor eshte parashikuar plotesimi i kerkeses si me poshte vijon: "Ofertuesi duhet te kete kryer sherbime te ngjashme ne nje vlere jo me pak se 40 % te fondit limit, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit. Kontrata te realizuara me autoritete kontraktore te cilat detyrimisht duhet te jene te shoqeruara me vertetimin e realizimit me sukses te saj, leshuar nga autoriteti kontraktor. Per sherbime te realizuara me subjekte private operatori ekonomik te paraqese faturat tatimore, (ku te shprehen qarte datat, shumat, sasite, emertimet, vlerat)."*

*Ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar si deshmi te eksperiencas se meparshme te ngjashme me objektin e kontrates te procedures se prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues jane dorezuar deshmi te furnizimeve te meparshme lidhur me persona juridik publik.*

*Ne respektim te kriterëve te vecanta te kualifikimit si edhe te nenit 27 pika 4 te Vendimit nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave vlereson te analizoje ne themel dokumentacionin e dorezuar ne proceduren e prokurimit objekt ankimi nga ana e operatorit ekonomik ankimues. Konkretisht, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se ankimuesi ka dorezuar:*

*Kontrate me DRFPP Nr.1,Tirane, Nr. 457 dt. 29.12.2016, Nr. 1026. dt. 29.12.2017-2018, me objekt "Sherbimi i Ruajtjes dhe Sigurise Fizike me roje private, me sistem alarmi dhe sistem Kamerash per Drejtorine rajonale te Formimit Profesional Publik", te instaluara nga Shoqeria jone, Referenca dhe Faturat perkatese,*

*Kontrate me OSHEE Shkoder Nr. 1518, dt. 20.10.2017, me objekt "Sherbimin e ruajtjes dhe Sigurise fizike te objekteve ne varesi te Drejtoria Rajonale Shkoder, per lotin e pare Shkoder", me vlere (17.022.981 Lek pa TVsh), dhe Reference per realizim Kontrate.*

*Kontrate me OSHEE-Burrel, Nr.1066, date 10.06.2016, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel", afat nga data 10.06.2016-09.06.2017, Vlere (27.534.444 Lek pa Tvsh dhe Faturat perkatese.*

*Kontrate me OSHEE-Burrel, Nr.440/6, date 07.06,2017, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel", me afat nga data 10.06.2017- 09.06.2018, vlere (27.174.180 lek Pa Tvsh) dhe Faturat perkatese,*

*Kontrate OSHEE-Burrel, Nr. 404/7, date 07.06.2018, "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel", me afat nga data 10.06.2018-09.06.2019, vlere (18.999.907 lek Pa Tvsh) dhe Faturat perkatese.*

*Nga analizimi i kontratave se mesiperme konstatohet se pergjithesisht "Objekti i kontratave" eshte parashikuar: "Sherbimi i ruajtjes dhe sigurise fizike me roje private, sistem alarmi dhe sistem kamerash dhe Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave".*

*Nga verifikimi i ofertes se operatorit ekonomik "Eurogjici Security" sh.p.k rezulton se ka paraqitur vertetim realizimi per keto kontrata. Gjithashtu Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se nga ana e operatorit ekonomik ankimues jane dorezuar fatura tatimore te shitjes.*

*Ne interpretim te nenit 27 pika 4 te Vendimit nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar, per te provuar eksperiencen e meparshme duhet te plotesohen krahas kushtit te vleres ne teresi te deshmise/ve se fumizimit edhe kerkesa mbi ngjashmerine e furnizimeve te realizuara, me objektin e procedures se prokurimit objekt ankimi. Ne respekt te kritereve te vecanta te kualifikimit si edhe te nenit 27 pika 4 te rregullave te prokurimit publik, nga analizimi ne teresi i natyres se sherbimeve referuar kontratave dhe faturave tatimore te shitjes, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave konstaton se ankimuesi ka provuar se ka kryer sherbime te cilat per nga natyra nuk jane te ngjashme me objektin e procedures se prokurimit, pasi jane sherbime ruajtje fizike per periudha te caktuara te cilat nuk kane te percaktuara vlerat e instalimit te sistemeve te alarmit. Nuk mund te pretendohet se ne specifikimet teknike te kontratave percaktohet qarte edhe ruajtja me sistem alarmi te objekteve pasi cmimet e ketyre sherbimeve nuk jane te shprehura ne kontrate dhe nga ana e Autoritetit Kontraktor eshte e pamundur llogaritja e ketyre zerave. Ne kete menyre nuk permbushet kerkesa e autoritetit kontraktor per furnizime te ngjashme te parashikuara ne dokumentet e procedures se prokurimit objekt ankimi.*

*Nga verifikimi ne sistemin elektronik te APP rezulton se Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Kontrate me I. Gjonaj Nr. 800. dt. 13.10.2017 me objekt "Instalim dhe Konfigurim te sistemit te alarmit me kamera me pajisjet e sipermarresit, vezhgim dhe monitorimin i panderprere 24 oresh ne ambiente te jashtme to objektit, Kontroll fizik, Grup te Gatshem 24ore ne 24 pa nderprerje, per te gjitha rastet kur provokohet sistemi i vezhgimit" dhe Faturat perkatese, ndryshe nga sa eshte pretenduar ne kete ankese.*

*Per arsyet e parashtruara me siper kerkesa per kete pike nuk mund te pranohet dhe konsiderohet e pambeshtetur ne ligj.*

*Ne mbeshtetje te nenit 19/1 dhe vijues, te Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, njezeri ka vendosur te mos pranoje ankesen e paraqitur nga operatori ekonomik "Eurogjici Security" sh.p.k per proceduren e prokurimit me Nr. Ref- REF-39828-10-16-2019 me objekt: "Instalim i sistemit te alarmit per linjen e furnizimit me gaz ne objektet parashkollore te Bashkise se Tiranes", me fond limit 1 365 900 (njmilion e treqind e gjashtedhjetete e pese mije e nenteqind) leke pa tvsh."*

II.5. Në datën 20.11.2019 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 06.12.2019 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1775/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 4163/1 prot., datë 04.12.2019, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,



## Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të shoqërisë “Eurogjici Security” sh.p.k, se: *“kontratat e paraqitura nuk kanë objektin e kërkuar në këtë procedurë prokurimi. “Instalim i sistemit të alarmit për linjën e furnizimit me gaz në objektet parashkollore të Bashkisë së Tiranës” është krejtësisht i ndryshëm nga instalimi i kamerave te sigurisë ne objekte”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, shtojca 11 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik e financiar”, gërma “d”, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

*“Ofertuesi duhet të ketë kryer shërbime të ngjashme në një vlerë jo me pak se 40 % të fondit limit, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Kontrata të realizuara me autoritete kontraktore të cilat detyrimisht duhet të jenë të shoqëruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj, lëshuar nga autoriteti kontraktor. Për shërbime të realizuara me subjekte private operatori ekonomik të paraqesë faturat tatimore, (ku të shprehen qartë datat, shumat, sasitë, emërtimet, vlerat).”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k., të depozituar për këtë procedurë prokurimi në sistemin elektronik të prokurimeve, rezulton se për të plotësuar kriterin e sipërpërmendur ka paraqitur:

- 1. Kontrate shërbimi lidhur me OSHEE Burrel, Nr. 1066, date 10.06.2016, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" me afat nga data 10.06.2016-09.06.2017 me vlere 27.534.439,03 Lek pa Tvsh, shoqëruar me vërtetim realizimi dhe fatura tatimore.*
- 2. Kontrat me OSHEE-Burrel, Nr. 440/6, date 07.06.2017, me objekt "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel" me afat nga data 10.06.2017- 09.06.2018, me vlere 25.115.917,21 lek pa Tvsh, shoqëruar me vërtetim realizimi dhe fatura tatimore.*
- 3. Kontrate OSHEE-Burrel Nr. 404/7, date 07.06.2018, "Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel", me afat nga data 10.06.2018-09.06.2019, vlere 18.999.907 lek Pa Tvsh, shoqëruar me vërtetim realizimi dhe fatura tatimore.*
- 4. Kontrate me OSHEE Shkoder Nr.1518, dt.20.10.2017, me objekt "Sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike te objekteve ne varesi te Drejtoria Rajonale Shkoder, per lotin e pare Shkoder", me vlere 17.022.981,72 Lek pa TVSH, shoqëruar me vërtetim realizimi dhe fatura tatimore.*
- 5. Kontrate me DRFPPNr.1, Tirane Nr.457 dt.29.12.2016, me objekt "Sherbimi i Ruajtjes dhe Sigurise Fizike me roje private, me sistem alarmi dhe sistem Kamerash per Drejtorine Rajonale te Formimit Profesional Publik", me vlerë 793.490 lekë pa tvsh, shoqëruar me vërtetim realizimi.*
- 6. Kontrate me DRFPPNr.1,Tirane Nr.1026. dt. 29.12.2017-2018, me objekt "Sherbimi i Ruajtjes dhe Sigurise Fizike me roje private, me sistem alarmi dhe sistem Kamerash*

*per Drejtorine Rajonale te Formimit Profesional Publik", me vlerë 768.141 lekë pa tvsh, shoqëruar me vërtetim realizimi dhe fatura tatimore.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.1.4. Në nenin 28, pika 3, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet: *"Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara."*

III.1.5. Referuar dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "Eurogjici Security" sh.p.k, në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, ky i fundit ka paraqitur në sistemin elektronik të prokurimeve tre kontrata të lidhura me OSHEE Burrel me objekt: *"Sherbim Sigurie per Ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave te Drejtorise Rajonale te OSHEE sh.a Burrel"*, që përfshin një periudhë tre vjecare, dhe që janë shoqëruar me fatura tatime shitje e vërtetime realizimi. Gjithashtu është paraqitur Kontrate me OSHEE Shkoder Nr.1518, dt.20.10.2017, me objekt *"Sherbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike te objekteve ne varesi te Drejtoria Rajonale Shkoder, per lotin e pare Shkoder"*, shoqëruar me vërtetim realizimi e fatura tatimore si dhe dy kontrata me DRFPPNr.1, Tirane për periudhën 2 vjecare (01.01.2017-31.12.2018) me objekt *"Sherbimi i Ruajtjes dhe Sigurise Fizike me roje private, me sistem alarmi dhe sistem Kamerash per Drejtorine Rajonale te Formimit Profesional Publik"*, me vërtetimet përkatëse dhe fatura tatimore për vitin 2018. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni, Komisioni konstaton se kontratat e lidhura me OSHEE Burrel si dhe kontrata e lidhur me OSHEE Shkodër kanë për objekt sherbimin e sigurisë per ruajtjen e ndertesave, njerezve dhe pronave, sherbim i cili nuk është i ngjashëm me objektin e prokurimit nw fjalw pwr instalimin e sistemit të alarmit për linjën e furnizimit me gaz në objekte. Kjo vërtetohet edhe nga faturat tatimore përkatëse si dhe vërtetimet e realizimit të lëshuara nga institucionet respektive, të cilat

shprehen për shërbim të realizuar me roje private në objektet e tyre, ndaj dhe këto kontrata nuk mund të merren në konsideratë si eksperiencia të ngjashme të realizuara nga ankimuesi.

Përsa i përket dy kontratave të lidhura me Drejtorine Rajonale te Formimit Profesional Publik Nr.1 rezulton se objekti i prokurimit përfshin shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike të objekteve me roje private si dhe sistem alarmi e sistem kamerash, për të cilat nga ana e ankimuesit nuk është paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë pjesën që zë realizimi i objektit të prokurimit me sinjal alarmi dhe kamera në totalin e vlerës së prokurimit, pasi është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, të paraqesë informacion dhe dokumentacion të saktë dhe vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me objektin e prokurimit. Për më tepër konstatohet se instalimi i sistemit të alarmit për linjën e furnizimit me gaz në objekte nuk është i ngjashëm me ruajtjen e objekteve me sinjalit të alarmi dhe kamera, pasi funksionet e tyre janë të ndryshme.

III.1.6. Referuar legjislacionit për prokurimin publik, Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në këto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik "Eurogjici Security" sh.p.k nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë se ka kryer shërbime të ngjashme në vlerën e caktuar nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë nuk përmbush kriterin e vendosur nga ky i fundit për eksperiencën e mëparshme të subjektit sikurse është parashikuar në shtojcën nr. 11 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

III.1.7. Kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e*

*kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Eurogjici Security” sh.p.k nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eurogjici Security” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr.REF-39828-10-16-2019, me objekt: *“Instalim i sistemit të alarmit për linjën e furnizimit me gaz në objektet parashkolllore të Bashkisë së Tiranës”*, me fond limit 1 365 900 lekë pa tvsh, zhvilluar ne daten 28.10.2019 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1775 Protokoli**

**Datë 20.11.2019**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**